



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2021:171222

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06916567

C.nr. 193/2021

Gjykata Themelore Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. R., të cilin me autorizim e përfaqëson Selmon Sadiku avokat në Kamenicë, kundër të paditurve, B. D. dhe B.K.që të, për shkak të vërtetimit e pronësisë sipas posedimit me mirëbesim, me vlere kontesti 9.800.00 euro, me datë 26.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së të paditurve, B.D. dhe B.K.qe te dy me adrese te panjohur.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurve e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi H. R. me, përmes të aoturizuarit të tij, ka parashtruar padi kundër të paditurve B.D. dhe B. K. që të dy me adresë të panjohur, për shkak të vërtetimit te pronësisë sipas posedimit me mirëbesim, me vlere kontesti 9.800.00 euro.

Gjykata me datë 22.07.2024, ka parashtruar Kerkese per Zyren e Gjendjes Civile ne Kamenice, Qendren per pune Sociale ne Kamenice dhe Stacionit Policor ne Kamenice per sigurimin e informatave apo njohurive per adresen e sakte te vendbanimit apo vendqendrimit per te paditurit B. D.dhe B. K., tani me vendbanim te panjohur.

Gjykata në rrugë zyrtare ka siguruar certifikatën e vdekjes për të paditurin B. K., sipas të cilës vërtetohet se B.K.i lindur me datë 16.09.1942 ka ndërruar jetë me datë 18.08.1979, në Kamenicë.

Me datën 22.07.2024, Gjykata i drejtohet Stacionit Policor në Kamenicë, me kërkesë për verifikimin e të dhënave lidhur me adresën për të paditurit B.K. dhe B. D., mirepo të njëjtit me datën 07.11.2024, e kanë njoftuar gjykatën se kanë vepruar në terren dhe sa i përket B. D., i njëjti është i vdekur.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e komfor nenit 277 pika a të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:171222, 26.02.2025**

Gjyqtarja,

Valbonë Dërvodeli, d.v.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.